VENDIM
Nr.12 datë, 15.3.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura", i ndryshuar, si dhe metodikës "Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik" në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. ujësjellës-kanalizime Tiranë:
a. tarifat e ujit për konsum publik, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
-Konsumator familjar:	33 lekë/ m^3	10 lekë/ m^3
-Institucione buxhetore:	110 lekë/ m^3	25 lekë/ m^3
-Ente private:	120 lekë/ m^3	25 lekë/ m^3
-Klientë të veçantë (Prodhim pije alkoolike, freskuese, pishina)	140 lekë/ m^3	25 lekë/ m^3
-Furra buke	95 lekë/ m^3	13 lekë/ m^3
-Shitje uji me shumicë (bashki,komuna)	10 lekë/ m^3	
-HEC Lanabregas	5 lekë/ m^3	

b. tarifën mujore fikse të shërbimit 100 lekë/ klient .

2. Bashkitë dhe komunat që blejnë ujë me shumicë do ta kryejnë faturimin në zonën e tyre të shërbimit me tarifa jo më të larta se tarifat (sipas llojit të klientëve) të miratuara për sh.a. ujësjellës-kanalizime Tiranë.

3. Pagesa rregullatore për sh.a. ujësjellës-kanalizime Tiranë do të jetë 1% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.03.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI I ERRU
Avni Dervishi